

VENDIM
Nr. 470, datë 26.7.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 114, DATË 1.3.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KONTINGJENCËS PËR
KOMPENSIMIN FINANCIAR TË RITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE PËR ÇDO TË PUNËSUAR ME PAGË
MINIMALE, PËR SHKAK TË RITJES SË KËSAJ PAGE NË SHKALLË VENDI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 114, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të kontingjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi”, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përdorimin e fondit të kontingjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të rritjes së pagës minimale në shkallë vendi”.

2. Pika 1, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënie kompensimi financiar për subjektet e përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, llogaritur mbi numrin e të punësuarve në fashën e pagës bruto nga 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë, për periudhën e kontributeve të muajit dhjetor 2022 dhe mbi numrin maksimal të të punësuarve, për periudhën kontributive prill–dhjetor 2023.”.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kompensimi financiar llogaritet dhe jepet bazuar në numrin maksimal të të punësuarve me fashën e pagës bruto 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë, që figurojnë në listëpagesën e deklaruar në organet tatimore, për muajin dhjetor 2022, për subjektet që ushtrojnë aktivitetin në sektorët e përcaktuar në pikën 2, të kreut I.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kompensimi financiar për subjektet, për periudhën prill–dhjetor 2023, jepet për numrin e të punësuarve për muajin që kërkon kompensim, por jo më shumë se numri maksimal i të punësuarve me fashën e pagës bruto 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë, të deklaruar për periudhën kontributive dhjetor 2022 dhe jo më shumë se numri i të punësuarve, për periudhën që kërkon kompensim.”.

c) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Subjektet private duhet të dorëzojnë kërkesë për aplikim elektronikisht nëpërmjet portalit “e-Albania”, për periudhën që kërkojnë kompensim.”.

4. Pika 1, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kompensimi financiar jepet në masën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, llogaritur mbi shtesën e pagës bruto nga 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë në 40 000 (dyzet mijë) lekë, për çdo muaj, për periudhën kontributive prill–dhjetor 2023.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku